

UDHËZIM

Nr.12, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.6, DATË 22.2.2006 "Mbi administrimin dhe detyrimet tatimore për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Formulari i deklarimit dhe pagesës së lojërave të fatit, i cili i bashkëngjitet udhëzimit nr.6, datë 22.2.2006 "Mbi administrimin dhe detyrimet tatimore për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", zëvendësohet me modelin bashkëlidhur, pjesë përbërëse e udhëzimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode